

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çfarë vjen pas vendimit të Hagës? Rinia më e guximshme se elita politike e ajo intelektuale
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/politike/fare-vjen-pas-vendimit-te-hages-rinia-me-e-guimshme-i1186024
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:23:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5e2b7fac84242d68480ed07f2a889116216d5ae225f669496474870406262bc6
TEKSTI	172e0b2bc0dc990f31f319bbd99be3413412764b42db5defdb3dfb71705826b4
PAMJA	2f3e0d61714542d0d42919dde8a4b321b428652c1a4d27f436d539a2dd591c50

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	25edbc11ba0f4ef3a34dfcbd6fd283c9f93f4193393330dadb99e2050f44cdf3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/25edbc11ba0f4ef3a34dfcbd6fd283c9f93f4193393330dadb99e2050f44cdf3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Çfarë vjen pas vendimit të Hagës? Rinia më e guximshme se elita politike e ajo intelektuale



Nga Leonora Koluka
28 Shtator 2026, 18:15 | Politikë



16 shtatori shënoi një nga ditët më të rëndësishme të procesit gjyqësor në Hagë.

Katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u shpallën fajtorë për disa krime lufte dhe u dënuan me gjithsej 81 vjet burgim.

Vendimi solli reagime të forta në Kosovë, protesta dhe një debat që tashmë shkon përtej sallës së gjyqit.

Por çfarë nënkupton ky aktgjykim për Kosovën, për drejtësinë dhe për një gjeneratë që luftën e njeh kryesisht përmes historisë?

Për Çlirim Hazirin dhe shumë të tjerë, këto protesta nuk janë vetëm reagim ndaj një aktgjykimi.

Ai është djali i Xhavit Hazirit, i cili është i zhdukur që nga lufta e fundit në Kosovë. Për vite me radhë, familja e tij ka pritur një përgjigje për fatin e tij.

Sot, Çlirimi është në krye të protestave kundër vendimit të Gjykatës Speciale, duke kërkuar drejtësi dhe duke thënë se zëri i tij dhe i protestuesve duhet të dëgjohet.

"Një ditë para vendimit, unë i kam ftuar të gjithë qytetarët që të mbledhemi në shesh e të presim bashkë atë natë, pastaj nesër të festojmë në sheshin 'Skënderbeu' triumfin e UÇK-së në raport me akuzat e fabrikua në Serbi. Mirëpo ndodhi e kundërta. Edhe kur u dënuan UÇK-ja, kur u dënua pjesa më e lavdishme e historisë së Kosovës, është krejtësisht e natyrshme që nuk mund ta pranojmë dhe nuk kemi rrugë tjetër përveç organizimit të protestave.", tha Çlirim Hazirin, organizator i protestave

"Mendoj që populli shqiptar po tregon çdo ditë e çdo natë që është në mbështetje të UÇK-së. Po tregon çdo ditë e çdo natë që UÇK-në, si në vitin '98-'99, si në këtë kohë të vështirë ku po tentohet të njolloset ajo pjesë e jona, e shtetësisë sonë, e ka në zemër, e mbështet në çdo formë. Sa i përket mbështetjes institucionale, mendoj që e ka pasur deri në një pikë, por kjo humbje e madhe tregon që nuk kemi arritur të triumfojmë dhe na nevojitet më shumë angazhim.", shtoi ai

"Historinë me babën tem e kam qe 35 vjet, jam djali i Xhavitit. Realisht, deri kur ka ardhë një pikë ku është rreziku të njolloset gjaku i dëshmorëve, unë nuk kam folë për këtë pjesë. Unë kam folë në një marsh të 'Liria ka emër', për shkak që e kam ndje që po tentohet të ndërtohet një proces i cili tenton të na njolloset gjakun e atyre dëshmorëve, të cilët e dhanë për lirinë e Kosovës.", tha Haziri.

"Baba im, po të ishte gjallë në mesin tonë, edhe gjithë dëshmorët, po të ishin, kishin me qenë në listë të Gjykatës Speciale. Kjo na tregon që Gjykata Speciale na ka thënë që ne

TE FUNDIT

Skandali me SHISH, ekspertja kanadeze e sigurisë: Zbuloni nëse ka të bëjë me një individ, apo me një rrjet më të gjerë

Fier, zjarr i madh në Kreshpan. rrezikohet edhe masivi pyjor me pisha

Iraku kërkon rrugë të reja për eksportin e naftës pas bllokimit të Ngushticës së Hormuzit

Sherri me avokatët, GJKKO në kolaps prej rregullores, 3 javë pa gjyqe

MË TË VIZITUARAT

PD kërkon pezullimin e territoriale, PS refuzon të presë konsultimet me bash...

Ukraina në vështirësi financiare, i duhen edhe 20 miliardë dollarë

Zjarri i madh në Pogradec, flakët drejt masivit me pisha

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

prindërit i kemi pasë terroristë, kriminelë, e janë kriminelë të vrarë për Gjykatën Speciale. E për ne, për popullin e Kosovës, nuk ka me qenë kështu. Për këtë rini, që unë po e them, i vetmi qetësim që e gjejmë pas atij vendimi është rinia e Kosovës, e cila UÇK-në e ka tatuazh në zemër e nuk do ta harrojë asnjëherë."

"Kur jau shoh djemtë, më dhimbsen se prindërit e tyre nuk ua ka marrë lufta, janë përgatitë me jetu me ta. Normal, më dhimbsen fëmijët, më dhimbsen shumë, se prindërit e tyre i kanë shpëtua luftës, nuk janë ata si unë e të tjerët, se na i ka marrë prindërit lufta. Por po i merr një padrejtësi mizore, një gjykatë që është ndërtu mbi mundin e sakrificën e baballarëve të tyre. Gjithsesi, edhe mbi gjakun e baballarëve tanë.", përfundoi ai.

Por përtej reagimeve dhe emocioneve që solli aktgjykimi, mbetet një pyetje thelbësore: çfarë ka vendosur konkretisht gjykata?

Të katër të akuzuarit u shpallën fajtorë për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje, ndërsa u liruan nga gjashtë pika të akuzës për krime kundër njerëzimit.

Vendimi është i shkallës së parë dhe mund të apelohe.

Aktgjykimi ka hyrë tashmë edhe në debatin politik në Kosovë.

Përplasjet rreth mënyrës se si duhet të reagohe ndaj vendimit, rolit të institucioneve dhe së ardhmes së Gjykatës Speciale e kanë bërë edhe më të ndërlikuar situatën politike në vend.

Për një pjesë të madhe të brezit të ri, lufta e Kosovës është një ngjarje që e kanë njohur përmes familjes, shkollës dhe historisë.

Por sot, për këtë brez, aktgjykimi i Hagës po bëhet pjesë e një historie që ende po shkruhet.

"Unë nuk kam arritë me përjetu luftën, kam arritë me dëgju shumë fjalë për të. E di që është e pastër, e di që secili qytetar i Kosovës është çu në këmbë për të. Besoj që është padrejtësi shumë e madhe. Ne si popull po mendohe mi me ngritë zërin tonë, për me u mundu me deklarë atë të pastër, ndaj njerëzve që nuk e konsiderojnë atë. Aktgjykimin e kemi pritur me padurim, por nuk e kemi pritur atë vendim. Ka qenë një dëshpërim shumë i madh. Gjykimi na ka demoralizuar...", tha studentja Dorina Hasanaj.

"UÇK-ja është thirrje e popullit për unitet kombëtar, për shtyrje të kauzave përpara dhe sinonim i çlirimit të Kosovës.", tha Studenti Flon Kastrati.

"Gjenerata jonë, që ka lindur pas luftës, besoj historitë e para i ka dëgjuar së pari në familje, te prindërit ose gjyshërit. Aty kanë filluar edhe rrëfimet e para për UÇK-në. Ne nuk kemi mujt me i përjetu, po secili e ka kriju një imazh në mendjen tonë se qysh ka mundur të jetë koha atëherë.", shtoi ai.

"Dënimi nuk i ka pëlqyer askujt. Ne, studentët, kemi bërë thirrje për unitet, si prej fuqive politike, si prej njerëzve. Nuk është koha për ndarje.", thesloi Kastrati.

Ndërsa në Hagë beteja juridike vazhdon, në Kosovë ende nuk ka një president të zgjedhur.

Një vendim historik, një proces apeli përpara dhe një ngërç politik që vazhdon. **(A2 Televizion)**



Partitë pa marrëveshje për presidentin e ri teksa afati po përfundon



Mblidhet sot për herë të parë Kryesia e Kuvendit të Kosovës të legjislaturës së 11-të



Serbët e Kosovës mes listës së Vuçiqit dhe asaj studentore



6 tetori, afati fundit për Presidentin. Gjykata vendosi: Zgjedhja e qeverisë nuk shkel Kushtetutën




Trump falënderon Kosovën për kontributin me trupa në Bordin e Paqes




Takime të ndara me Kurtin dhe Vuçiq, Kallas kërkon përparim në dialog

Latest Videos



"Vlora Hyseni" mbledh shtetin dhe SPAK, çfarë ndodhi në Këshillin e Sigurimit?



U lanë jashtë Broja e Bajrami, Vata: Të jenë pjesë e grupit edhe pse nuk janë në formën më të mirë





Ka ardhur koha që të kemi një trajner shqiptar? Vata: Nuk shikojmë figurat e rëndësishme...



Shqipëria e nis mbarë Ligën e Kombeve, Vata: Me energjinë e Silvinjos ishte ndryshe, humbjet para...

Shqipëria

Aktualitet

Kronikë

Politikë

Ekonomi

Sociale

Kulturë

Moti

Kosova

Kulturë

Sociale

Ekonomi

Politikë

Kronikë

Aktualitet

Rajoni & Bota

Ballkani

Bota

Argëtim

Showbiz

Lifestyle

Kapur në kamera

Teknologji

Sport

Live Euro 2024

Futboll

Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta

A2 CNN në Izrael

31 Minuta

A2 CNN në Ukrainë

Lumi i kokainës

Ditari ndërkombëtar

Zbulo

Imagjinatë

Dëshmi

A2 CNN LOGO

Live TV

Preth nesh

Kushtet e Privatësisë

Karriera

Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk

All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediodesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.